



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 11 Mars 2021

Nr: 138

VENDIM

**PËR KTHIMIN PËR KORRIGJIM TË DOKUMENTACIONIT TË LISTËS
SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE PËR DEPUTET TË DEPOZITUAR NGA
KOALICIONI “ALEANCA” (AL) PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN TË DATËS 25
PRILL 2021**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, neni 67, neni 72 dhe neni 73, pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe udhëzimit nr.1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”,

V Ë R E J:

Koalicioni “Aleanca” është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.

Në bazë të neneve 67 e 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, koalicioni “Aleanca” ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e listave shumëmemërore për 12 zona zgjedhore.

Në bazë të nenit 73 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve verifikoi listat shumëmemërore të kandidatëve për deputet të Koalicionit “Aleanca” dhe dokumentacionin bashkëngjitur. Në përfundim të procesit të verifikimit paraprak u konstatuan mangësi dhe mospërmbushje të dokumentacionit si më poshtë:

1. Koalicioni “Aleanca” nuk ka paraqitur dokument provues për plotësimin e kërkesave të nenit 68 të Kodit Zgjedhor. Koalicioni ka paraqitur vërtetimin për zotërimin e 2 (dy) mandateve në Kuvend. Partitë pjesëtare të koalicionit “Aleanca” nuk vërtetojnë se zotërojnë bashkërisht në Kuvend numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit. Gjithashtu nuk janë paraqitur listat mbështetëse me jo më pak se 7,000 zgjedhësve në shkallë kombëtare.



2. Kërkesa për regjistrim e listave shumëmemërore të kandidatëve për deputet të koalicionit “Aleanca” për të gjitha zonat zgjedhore nuk është në përputhje me pikën 3 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, përjashtuar kryetari i partisë udhëheqëse të koalicionit i cili në zgjedhjet për Kuvend mund të regjistrohet deri në 4 zona zgjedhore. Kryetarët e partive të tjera pjesëmarrëse të koalicionit duhet të jenë të regjistruar vetëm në një zonë zgjedhore dhe për rrjedhojë të figurojnë vetëm në një listë të një zone zgjedhore. Konstatohet se z. Joan Velko është renditur në 6 zona zgjedhore (Qarqet Tiranë, Fier, Lezhë, Vlorë dy herë, Gjirokastrë dhe Kukës), z. Valentino Mustaka është listuar në dy zona zgjedhore (Berat, Fier dhe Vlorë), z. Gaqo Apostoli është renditur në dy zona zgjedhore (Tiranë dhe Korçë)
3. Kërkesa për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Berat**, nuk është në përputhje me pikën 3 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor. Kandidati me numër rendor 1, z. Valentino Mustaka ka mangësi me dokumentacionin e kandidimit të parashikuar në nenin 72 të Kodit Zgjedhor në lidhje me kartën e identitetit. Kandidatët me numër rendor 8 dhe 9. zj. Mimoza Bineri dhe z. Joan Mashani nuk plotësojnë kriterin për tu regjistruar si kandidat të listës shumëmemërore vetëm në një zonë zgjedhore. Në dokumentacionin e kandidimit konstatohen se ka parregullsi në dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 8. zj. Mimoza Bineri dhe numër rendor 9. z. Joan Mashani.
4. Kërkesa për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Dibër**, nuk është në përputhje me pikën 3 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, kandidati me numër rendor 2, nr. 3, nr. 5, nr. 6, nuk plotësojnë kriterin për tu regjistruar si kandidat të listës shumëmemërore vetëm në një zonë zgjedhore.
5. Kërkesa për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Elbasan** nuk është në përputhje me pikën 3 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, kandidatët me numër rendor 6, nr. 7, nr. 13, nr. 14, nr. 15, nuk plotësojnë kriterin për tu regjistruar si kandidat të listës shumëmemërore vetëm në një zonë zgjedhore. Konstatohen se ka parregullsi në dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 1. z. Eduart Abazi, numër rendor 6. zj. Lirije Bezhani, numër rendor 13. zj. Enerjeta Rryçi, numër rendor 14. z. Flamur Karaj dhe numër rendor 15. z. Qani Haskasa. Kandidati për deputet me numër rendor 9. zj. Marinela Hala, rezulton që faqja 1. 3. 4. 5 është i pashënuar emër, mbiemër, firmë.
6. Kërkesa për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Durrës** nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor. Janë përcaktuar 14 kandidatë dhe është lënë pa plotësuar numri rendor 1. Kandidatët me numër rendor 9, nr. 10, nr. 11 nr. 14, nr. 15, nuk plotësojnë kriterin për tu regjistruar si kandidat të listës shumëmemërore vetëm në një zonë zgjedhore. Në dokumentacionin e kandidimit konstatohen se ka parregullsi në



- dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 11. zj. Lirije Bezhani dhe numër rendor 14. zj. Fidane Grosha.
7. Kërkesa për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Gjirokastrë** nuk është në përputhje me pikën 3 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor. Kandidatët me numër rendor 3, nr. 4, nr. 5, nuk plotësojnë kriterin për tu regjistruar si kandidat të listës shumëmemërore vetëm në një zonë zgjedhore. Në dokumentacionin e kandidimit konstatohen se ka parregullsi në dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 3. zj. Mimoza Bineri, numër rendor 4. z. Joan Mashani, numër rendor 5. zj. Irena Sakaj dhe numër rendor 6. z. Joan Velko.
 8. Kërkesa për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Vlorë**, nuk është në përputhje me pikën 3 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor. Kandidati me numër rendor 2 është i njëjtë me kandidatin me numër rendor 10 në po të njëjtën listë shumëmemërore të të njëjtës zonë zgjedhore. Emrat e tjerë të kandidatëve në listë janë paraqitur në zona zgjedhore të tjera. Në dokumentacionin e kandidimit konstatohen se ka parregullsi në dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 12. zj. Mimoza Bineri. Kandidati për deputet me numër rendor 8. z. Blesar Beqo, rezulton që pika 8, është e pa plotësuar.
 9. Kërkesa për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Lezhë** nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke mos e plotësuar numrin e kërkuar me 1 kandidatë, me pikën 3 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor kandidatët me numër rendor 5, nr. 6, nr. 7, nr. 8, nr. 9, nuk plotësojnë kriterin për tu regjistruar si kandidat të listës shumëmemërore vetëm në një zonë zgjedhore pasi janë regjistruar edhe në një zonë tjetër zgjedhore. Konstatohet se nuk është respektuar kuota gjinore sipas pikës 6 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor. Në dokumentacionin e kandidimit konstatohen se ka parregullsi në dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 5. z. Lazer Kodra, numër rendor 6. z. Ndoc Ndoja, numër rendor 7. z. Dod Gjerkaç, numër rendor 8. zj. Albana Elezi dhe numër rendor 9. z. Pellumb Zallumi.
 10. Kërkesa për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Korçë**, nuk është në përputhje me pikën 3 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor kandidati me numër rendor 2 nuk plotëson kriterin për tu regjistruar si kandidat i listës shumëmemërore vetëm në një zonë zgjedhore. Rezulton që kandidati për deputet me numër rendor 7. z. Lambert Jorganxhi, nuk ka të depozituar faqen nr. 6 të formularit të vetëdeklarimit.
 11. Kërkesa për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Fier** nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke mos e plotësuar



numrin e kërkuar me 3 kandidatë , me pikën 3 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor kandidatët me numër rendor 8, nr. 11, nr. 12, nr. 13, nr.14, nr. 15 nuk plotësojnë kriterin për tu regjistruar si kandidat të listës shumemërore vetëm në një zonë zgjedhore. Konstatohen se ka parregullsi në dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 8. zj. Mimoza Bineri, numër rendor 9. z. Mikel Naqellari, numër rendor 10. z. Ervin Telo, numër rendor 11. z. Joan Mashani, numër rendor 12. zj. Irena Sakaj, numër rendor 13. z. Joan Veklo dhe numër rendor 14. z. Elidjon Thanasi.

12. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Kukës** nuk është në përputhje me pikën 3 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor kandidati me numër rendor 3, nuk plotëson kriterin për tu regjistruar si kandidat i listës shumemërore vetëm në një zonë zgjedhore. Konstatohet se nuk është respektuar kuota gjinore sipas pikës 6 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor. Në dokumentacionin e kandidimit konstatohen se ka parregullsi në dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 3. z. Dod Gjerkaç.
13. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Shkodër** nuk është në përputhje me pikën 3 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor kandidatët me numër rendor 1, nr. 2, nr. 3, nr. 4, nr. 5, nr. 7, nr. 8, nr. 10, nr. 11, nr. 12, nr. 13, nuk plotësojnë kriterin për tu regjistruar si kandidat të listës shumemërore vetëm në një zonë zgjedhore, emrat e kandidatëve në listë janë dublikuar. Konstatohet se nuk është respektuar kuota gjinore sipas pikës 6 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor. Jetëshkrimi (Model 07) i kandidatit për deputet me numër rendor 2, z. Ndoc Ndoja mungon. Kandidati për deputet me numër rendor 4 zj. Albana Elezi, konstatohet se ka parregullsi në dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit si dhe rezulton që të jetë kandidat me numër rendor 10 në po të njëjtën listë shumemërore. Kandidati për deputet me numër rendor 5. z. Pellumb Zallumi, konstatohet se ka parregullsi në dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit. Konstatohen se ka parregullsi në dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit të kandidateve për deputet me numër rendor 4 .zj. Albana Elezi, numër rendor 5. z. Pellumb Zallumi, numër rendor 7. zj. Elda Xhekaliu, numër rendor 8. z. Denis Nika numër rendor 9. z. Gjovalin Shqalshi dhe numër rendor 12. zj. Enerjeta Rryçi.
14. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Tiranë** ka mospërmbushje për dokumentet e kandidimit. Kandidati për deputet me numër rendor 3, z. Vllasova Musta, ka mangësi me dokumentacionin e kandidimit të parashikuar në nenin 72 të Kodit Zgjedhor. Kandidatëve me numër rendor 1, z. Eduart Abazi dhe 29, zj. Gëzimi Xhixhe, ju mungon kopja e dokumentit të identifikimit. Konstatohen se ka parregullsi në dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 2. z. Gaço Apostoli dhe numër rendor 33. z. Klajdi Bufi. Në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për



deputet me numër rendor 3. zj. Vllasova Musta, rezulton që pika 8, është e pa plotësuar. Kandidati për deputet me numër rendor 36. zj. Mirela Hoxha, rezulton që faqen numër 1 nuk ka shkruajtur emër, mbiemër, firmë.

15. Deklarata e kandidatit modeli 05, për të gjitha zonat zgjedhore është plotësuar gabim.

Në bazë të nenit 73 pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dokumentacioni i depozituar kthehet për korrigjim, subjektit zgjedhor, Koalicioni “Aleanca”.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 67, 72 dhe 73, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe udhëzimin nr. 1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”.

V E N D O S :

1. Kthimin për korrigjim, sipas gjetjeve të renditura më sipër, të dokumentacionit për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për deputet, të Koalicioni “Aleanca”, (AL) për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.
2. Dokumentacioni i korrigjuar të depozitohet brenda datës 16.03.2021.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

